



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

VENDIM

K.P.P. 542/2019

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Evis Shurdha	Kryetar
Enkeleda Bega	Nënkryetar
Vilma Zhupaj	Anëtar
Lindita Skeja	Anëtar
Merita Zeqaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 14.08.2019, shqyrtoi ankesën me:

Objekt:

Shfuqizimin e vendimit të KVO-së për skualifikimin e ofertës të BOE “Colombo” sh.p.k. & “Ed Konstruksion” sh.p.k., në procedurën e prokurimit, “Procedurë e Hapur”, me nr. REF-19646-04-25-2019, me objekt: “Rikonstruksion i shkollës “24 Maji” dhe ambienteve sportive, Vlorë”, me fond limit 82,981,479 lekë (pa TVSH), zhvilluar në datën 03.06.2019, nga autoriteti kontraktor, Bashkia Vlorë.

Shfuqizimin e vendimit të KVO-së për kualifikimin e ofertës të operatorit ekonomik “Senka” sh.p.k., në procedurën e prokurimit të sipërcituar.

Ankimues:

BOE “Colombo” sh.p.k. & “Ed Konstruksion” sh.p.k.
Adresa: L. “Kryengritja e Fierit”, Rr. “Vangjel Rrushku”, Fier.

Autoriteti Kontraktor:

Bashkia Vlorë
Adresa: Sheshi “4 Heronjtë”, Rr. “Osman Haxhiu”, Vlorë.

Baza Ligjore:

Ligji nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” neni 19/1 e vijues, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funkcionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim të ankuesit, dokumentacionin e paraqitur nga autoriteti dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

Vëren:

I

Vlerësimi paraprak

I.1. Pas shqyrtimit paraprak të ankesës dhe të dokumentacionit të dërguar nga operatori ekonomik ankimues dhe autoriteti kontraktor, Komisioni i Prokurimit Publik konstatoi se, mbështetur në pikën 1 të nenit 63 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, operatori ekonomik ankimues kanë *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.2. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur fillimisht ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe, më pas, ka paraqitur ankesë, pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si organi më i lartë në fushën e prokurimeve, që shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit, në përputhje me kërkesat e percaktuara në ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”.

I.3. Ankimuesi ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

Në këto kushte Komisioni i Prokurimit Publik mori në shqyrtim në themel objektin e ankesës të operatorit ekonomik ankimues.

II

Rrethanat e çështjes

II.1 Në datën 26.04.2019, në sistemin e prokurimeve elektronike është publikuar procedura e prokurimit, “*Procedurë e Hapur*”, me nr. REF-19646-04-25-2019, me objekt: “*Rikonstruksion i shkollës “24 Maji” dhe ambienteve sportive, Vlorë*”, me fond limit 82,981,479 lekë (pa TVSH), zhvilluar në datën 03.06.2019, nga autoriteti kontraktor, Bashkia Vlorë.

II.2 Në datën 03.06.2019, autoriteti kontraktor ka zhvilluar procedurën e prokurimit.

II.3. Në datën 10.06.2019, autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorët ekonomikë pjesëmarrës, me anë të sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi rezultatet e vlerësimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave ku rezulton si më poshtë vijon:

- | | |
|--|------------------------------------|
| 1. ”Air Komponent” sh.p.k. | pa ofertë ekonomike, Skualifikuar; |
| 2. ”Elda-VI” sh.p.k. | pa ofertë ekonomike, Skualifikuar; |
| 3. ”Colombo” sh.p.k. & ”Ed Konstruksion” sh.p.k. | 65,024,033 lekë, Skualifikuar; |
| 4. “Leon Konstruksion” sh.p.k. | 70,282,691 lekë, Skualifikuar; |
| 5. “Senka” sh.p.k. | 81,099,865 lekë, Kualifikuar; |

II.4.Me anë të sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), autoriteti kontraktor ka njoftuar BOE “Colombo” sh.p.k. & “Ed Konstruksion” sh.p.k. për skualifikimin e ofertës së tij, për procedurën e prokurimit objekt shqyrtimi, me arsyetimin si më poshtë vijon:

“- Në plotësimin e vetëdeklaratës me shkrim të subjektit, të paraqitur nga anëtarët e bashkimit vecmas, në ditën e hapjes së ofertës, sipas shtojcës 8, rezulton se nuk përcakton të gjithë ortakët, administratorët. Në shtojcën 8 të dst përcaktohet se operatori ekonomik deklaron “personi/at në cilësinë e anëtarit të organit administrativ, drejtuesit ose mbikëqyrësit, aksionerit ose ortakut, ose ka kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik”. Konkretisht nga verifikimi i ekstraktit historik të shoqërisë “COLOMBO” rezulton se ka edhe nje drejtues teknik Erjona Qatipi të padeklaruar në shtojcën 8, kurse nga verifikimi i ekstraktit historik të shoqërisë “ED KONSTRUKSION” rezulton se ka të padeklaruar në shtojcën 8, ortakun E. I., J. I., R. I., ekspertit kontabël V. L..

- Nga verifikimi i dokumentacionit në përmbushje të pikës 2.3.6 “Për kapacitetin teknik” të dst, rezulton se licenca kategoria III.2.B, e paraqitur nga operatori ekonomik “ED KONSTRUKSION” shpk ka për objekt për mbetjet urbane. Ky fakt përforcohet edhe nga Akti i Miratimit që shoqëron licencën ku përcaktohen llojet e mbetjeve urbane për të cilat është lëshuar.

- Në përmbushje të pikës 2.3.13 “Për kapacitetin teknik” të dst, nga shoqëria “ED KONSTRUKSION” shpk, nuk është paraqitur dokumentacion për të provuar se disponon një mjet Autobot. Nga shoqëria “COLOMBO” janë deklaruar se disponohen 2 mjete autobote, nga të cilat 1 me kontratën e qirasë me subjektin “Kond” me targa AA120NA, ku rezulton, se ky mjet i është dhënë më parë me qera edhe një subjekti tjetër, pjesëmarrës në këtë procedurë, kurse për mjetin me targa AA224HF i lëshuar me qira nga subjekti “Baitel” ka lejen e transportit të përfunduar në datë 29.04.2019.

- Makinaria për shperndarrjen uniforme të kokrizave të gomës të barit artificial, në përmbushje të pikës 2.3.13 “Për kapacitetin teknik” të dst, e disponuar me kontratën e qirasë me nr.1089 rep datë 22.05.2019, të lidhur nga shoqëria “COLOMBO” me shoqërinë “Neë Albajrak”, rezulton i dhënë me qera edhe një subjekti tjetër, pjesëmarrës në këtë procedurë prokurimi.

- Në përmbushje të pikës 2.3.13 “Për kapacitetin teknik” të dst, Sperkates boje / makineri vijezimi, e deklaruar se disponohet nga të dy anëtarët e B.O.E, nga verifikimi i kryer rezulton se përcakton Sperkates boje, por duke u nisur nga vlera nuk është për makineri vijezimi në rrugë, trotuare etj, sikurse është qëllimi i vendosjes në dokumentat e tenderit.

- Bazuar në ndarjen e punimeve midis shoqërive anëtare të B.O.E, rezulton se shoqëria “ED KONSTRUKSION” ka marrë përsipër të kryeje zërat e preventivit “punime murature”, “punime shtresash”, “punime suvatimi e bojatisje të jashtme”. Nga verifikimi i këtyre zërave dhe dokumentacionit të paraqitur, rezulton se kërkesat profesionale dhe ato teknike nuk përmbushen nga shoqëria “ED KONSTRUKSION”, në përputhje me përqindjen e pjesëmarrjes në punë, të përcaktuara në akt marrëveshje. Konkretisht në preventivin e këtij prokurimi janë marrë përsipër të kryhen punime ndërtimore si psh “veshje fasade me polisterol kompakt jeshil T=5cm + rrjete + suva”, punime që kërkojnë drejtues teknik me profesion inxhinier në profilet e ndërtimit ose arkitekt, për pasojë edhe inxhinieri që do të kryejë zbatimin e punimeve përkatëse duhet të jetë i certifikuar për auditimin e energjisë, nga institucionet e arsimit të lartë, por që ky inxhinier i certifikuar nuk disponohet nga shoqëria ED KONSTRUKSION” që ka marrë përsipër të kryejë këto punime. Përveç kësaj për efekt të kryerjes së punimeve ndërtimore është gjykuar i nevojshëm që punonjësit që do të realizojnë punimet e ndërtimit të asistohen edhe nga një teknik ndërtimi, por që nga dokumentacioni i paraqitur në SPE nuk disponohet nga shoqëria “ED KONSTRUKSION”.

- Në përmbushje të pikës 2.3.13 "Për kapacitetin teknik" të dst, janë kërkuar 2 copë kamionçinë me kapacitet mbajtës 1.5 -2 ton. Nga shoqëria "ED KONSTRUKSION" janë paraqitur dy mjete me targa AA233MN dhe AA305TM që janë konsideruar në rregull me dokumentacionin, kurse nga shoqëria "COLOMBO" janë paraqitur mjetet VL5914C, VL4533B, VL9884A, VL6465B, AA747ID, AA416KL që kanë dokumentacionin të pashoqëruar me leje transporti, ose janë me kapacitet nën 1,5 ton. Si pasojë B.O.E nuk ka mundur të paraesë 3 copë mjete me dokumentacion e plotë ligjor, sikurse është përcaktuar në dst."

II.5.Në datën 17.06.2019, BOE "Colombo" sh.p.k. & "Ed Konstruksion" sh.p.k. ka paraqitur fillimisht ankesë pranë autoritetit kontraktor duke kundërshtuar vendimin e KVO-së për skualifikimin e ofertës së tij, si dhe duke ngritur pretendime mbi ofertën e paraqitur nga operatori ekonomik "Senka" sh.p.k. në procedurën e prokurimit objekt shqyrtimi.

II.6.Nga verifikimet e kryera në dokumentacionin e paraqitur pranë KPP, me anë të shkresës Nr. 5212/2 Prot. datë 24.06.2019, autoriteti kontraktor i ka kthyer përgjigje BOE "Colombo" sh.p.k. & "Ed Konstruksion" sh.p.k., duke mos e pranuar ankesën e paraqitur prej tij.

II.7.Në datën 28.06.2019, BOE "Colombo" sh.p.k. & "Ed Konstruksion" sh.p.k. ka paraqitur ankesë pranë Komisionit të Prokurimit Publik me të njëjtin objekt me ankesën e dorëzuar pranë autoritetit kontraktor, për procedurën e prokurimit objekt shqyrtimi, duke argumentuar si më poshtë vijon:

"[...]Ne lidhje me pretendimin se "Ne plotesimin e vetedeklarates me shkrim te subjektit, te paraqitur nga antaret e bashkimit vecmas, ne ditën e hapjes se ofertes, sipas shtojces 8, rezulton se nuk percakton te gjithë ortaket, administratoret. Ne shtojcen 8 te dst percaktohet se operatori ekonomik deklaron "Personi/at në cilësinë e anëtarit të organit administrativ, drejtuesit ose mbikëqyrësit, aksionerit ose ortakut, ose ka kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik". Konkretisht nga verifikimi i ekstraktit historik te shoqerise "COLOMBO" rezulton se ka dhe nje drejtues teknik E. Q. te padeklaruar ne shtojcen 8, kurse nga verifikimi i ekstraktit historik te shoqerise "ED KONSTRUKSION " rezulton se ka te padeklaruar ne shtojcen 8, ortakun E. I., J. I., R. I., ekspertit kontabel V. L.

Sqarojme se: Shoqeria Colombo Shpk ka si ortak dhe Administrator te vetem znj.Diana Laba ndersa caktimi si Drejtuese Teknik i znj.E. Q. eshte bere vetem per Licencen III.2.B per te aplikuar per kete Licence, per me teper ne ekstrakt eshte shprehur qarte "VETEM PER LICENCEN ME KODIN III.2.B" perkatesishte sipas Ekstraktit; "Numri i ceshtjes: CN-145396-03-19 Arsyet e hapjes se ceshtjes: Depozitimi i vendimit. datë 18.03.2019 për emërimin e E. Q. si Drejtuese teknike e shoqerise vetem per licencen Kodi III.2.B "Veprimtari te lidhur me grumbullim, transport, ruajtje, riciklim, perpunim apo asgjesim i mbetjeve te llojeve te ndryshme". Kane ndodhur ndryshimet e meposhtme te drejtuesit teknik: eshte shtuar anetari: ("E. Q.") Nga data "18/03/2019". Pra sic vihet re nuk ka aspak lidhje me administrimin e shoqerise ne aktivitetin e Licences se Zbatimit ne ndertim. I njejti arsyetim vlen edhe per shoqerin ED Konstruksion Shpk, ku V. L. eshte Eksperte Kontabel dhe nuk ka lidhje me Administrimin e shoqerise. Nga ana jone dhe shoqerise ED KONSTRUKSION Shtojca 8 eshte plotesuar ne menyre korrekte dhe eshte firmosur nga perfaqesuesi ligjor i shoqerive perkatese. Nese nga AK pretendohet se kemi informacion te sajuar, nese dikush nga ortaket e shoqerive eshte i denuar apo eshte ne ndjekje per vepra penale eshte detyrimi i tij ligjore te verifikoni duke ju drejtuar institucioneve perkatese. Sa me siper pretendimi i

AK eshte i qellimshem, dhe tregon haptazi se eshte tentuar me te gjitha menytrat te sajoje mangesi ne dokumentacionin e paraqitur nga ana jone me qellim per te na skualifikuar.

Ne lidhje me pretendimin se “Nga verifikimi i dokumentacionit ne permbushje te pikes 2.3.6 "Per kapacitetin teknik” te dst rezulton se licenca kategoria III.2.B, e paraqitur nga operatori ekonomik “ED KONSTRUKSION” Shpk ka per objekt per mbetjet urbane. Ky fakt perforecohet edhe nga Akti i Miratimit qe shoqeron licencen ku percaktohen llojet e mbetjeve urbane per te cilat eshte leshuar”.

Sqarojme se: Licenca III.2.B qe disponon shoqeria “ED KONSTRUKSION” Shpk dhe te paraqitur ne kete procedur i tejkalone edhe kerkesat te vendosura nga AK ne DST. Gjithashtu ju sjellim ne vemendje se kjo shoqeri ushtron aktivitet ne fushen e ndertimit dhe se ne te gjitha procedurat e meparshme ne te cilat kjo firme ka qene pjesemarrrese, eshte kualifikuar dhe eshte shpallur fituese dhe nuk i ka rezultuar si magesi ky dokumentacion, disa nga procedurat ne te cilat eshte shpallur fitues nga Autoritet Kontraktor jane Bashkia Tirane, Bashkia Kucove, Bashkia Lezhe, Bashkia Sarande etj. Duke ju referuar preventivit te objektit rezultone se kemi te bejme me vloume pune te cilat mbulohen totalisht nga licencat e shoqerive pjese e bashkimit, nga mjetet e transportit dhe makinerit e kerkuara nga AK ne DST, te cilat i plotesojne te dy subjektet ne menyre korrekte. Per me teper proceset e punes pjese e preventivit nga te cilat vijne mbetjet inerte si, prishje suvatimi, prishje betoni etj., jane mbetje te cilat nuk depozitohen por ngarkohen direkt me makineri dhe transportohen ne vendin e caktuar nga ana e bashkise, pra nuk behet grumbullim i tyre dhe ky proces pune kryhet me se miri nga OE sic ka rezultuar dhe ne zbatimin e kontratave te mepareshme qe ne kemi dal fitues nga AK Bashkia Vlore si investitor dhe qe jane realizuar me mire se cdo Kontraktues tjeter. Skualifikimi i AK ne lidhje me kete kerkese nuk perben aspak argument bindes per skualifikimin e shoqerise sone por eshte i qellimshem dhe nuk pranohet nga ana jone.

Ne lidhje me pretendimin “Ne permbushje te pikes 2.3.13 “Per kapacitetin Teknik te dst nga shoqeria ED KONSTRUKSION“ shpk nuk eshte paraqitur dokumentacion per te provuar se disponon nje mjete Autobot. Nga shoqeria COLOMBO jane deklaruar se disponon 2 mjete autobote, nga te cilat 1 me kontraten e qerese me subjektin Kond” me targa AA120NA, ku rezulton se ky mjet i eshte dhene me pare me qera edhe nje subjekti tjeter, pjesemarrres ne kete procedure, kurse per mjetin me targa AA224HF i leshuar me qera nga subjekti “Baitel” ka lejen e transportit te perfunduar me date 29.04.201

Sa me siper sqarojme se : Se pari; ju bejme me dije se subjekti qeradhenes, shoqeria BAITEL Shpk, ka aplikuar prane Bashkise Vlore per rinovimin e kesaj leje por nga ana e ketij Institucioni njekohesishte ne rolin e Autoritetit Kontraktor ne kete procedur ne menyre te qellimshme nuk eshte bere rinovimi i Lejes se Transportit duke e ditur se ne procedurat e mepareshme te zhvilluara nga prej tij, shoqeria Colombo ka parqitur kete Autobot me targa AA224HF, si dhe duke menduar se ne nuk do te paraqiteshim me dokumentacion tjeter do te kishte si mangesi Autobotin e Ujit. Ne kushtet kur Autoriteti Kontraktor ka njohuri te plote te dokumentacionit te shoqerise sone nga procedurat e mepareshme ne te cilat kemi marr pjese, madje jemi shpallur dhe fitues ka hartuar kriteret te cilat ka menduar se nuk do te plotesohen nga ana jone. Madje per te penguar pjesemarrjen tone ne kete procedur njekohesishte si organ i cili leshon lejen e transportit te cilin AK na e konstaton si magesi qellimisht nuk eshte rinovuar nga ana tyre, duke cuar edhe ne veper penale, mosbarazia ne tendera. Sa me siper veprime te tilla ne kundersiztim dhe ne shkelje te hapur te ligjit te prokurimeve, duke nxitur shkeljen e barazise kompromentojne AK duke cuar ne kryerje te veprave penale. Gjithashtu ne kete procedur per te plotesuar kerkesat e DST nga ana jone eshte paraqitur Autoboti i ujit me traga AA120NA per te cilin eshte paraqitur gjithë dokumentacioni ligjor i kerkuar. Ne lidhje me pretendimin se ky Autobot eshte paraqitur edhe nga subjekti tjeter ne kete procedur, por qe ne

menyre te qellimshme nga AK nuk eshte permendur operatori tjetër qe e disponon cka i kompromenton ne qendrimin qe mbajn. Se pari; Pretendimi AK nuk mund te merret parasysh nga ana jone per sa kohe mbahet i fshehur emri i operatorit tjetër ekonomik qe e diponon kete mjete pervece shoqerise sone. Ndoshta ky OE eshte shoqeria SENKA, te cilen AK me cdo kushte ka arritur ta kualifikoje dhe me cdo kushte kerkoni ta shpall fitues. Jeni te lutur te beni vleresime reale te dokumentacionit pasi kontrata e qeras e lidhur midis Colombo dhe KOND Shpk eshte nje kontrate plotesisht ligjore, ne te cilen shprehet qarte se revokon cdo kontrate te mepareshme te lidhur para kesaj kontrate per kete mjete, ne kete menyre shoqeria SENKA qe ka paraqitur kete Autobot me kontrate qeraje eshte e pavlefshme dhe si rrjedhim dokumentacioni i paraqitur prej saj eshte i rreme me qellim kualifikimi. Se dyti; Referuar dhe vendimeve te mepareshme te KPP-se Vendim nr.157/2018 fakti qe dy OE pjesemarrese disponojne me qera te njetin mjete nuk mund dhe nuk duhet te perbeje shkake skualifikimi pasi mjeti do te perdoret nga OE i cili do te shpallet fitues. Krirteri i vendosur nga ana AK eshte plotesuar nga shoqeria jone dhe pretendimi AK eshte i pabaze, i qellimshem dhe nuk mund te pranohet nga ana jone.

Ne lidhje me pretendimin se "Makineria per shperndarjen uniforme te kokrizave te games te barit artificial, ne permbushje 2.3.13 "Per kapacitetin teknik "te dst, e disponuar me kontraten e qeras nr.1089rep date 22.05.2019, te lidhur nga shoqeria "COLOMBO" SHPK me shoqerin "Neë Albajrak" rezulton i dhene me qera edhe nje subjekti tjetër, pjesemarres ne kete procedur prokurimi.

Sqarojme se: fakti i evidentuar nga Autoriteti Kontraktor se kjo makineri i eshte dhene me qera edhe nje OE pjesemarres ne kete procedur është një argument që nuk mund dhe nuk duhet të shërbejë dhe tjetërsojë kontratat e lidhura mes shoqërive qeradhënëse dhe shoqërisë e aq më pak të shërbejë automatikisht si shkak skualifikimi, ndërkohë që faktikisht referuar kriterit të përcaktuar në dokumentat e tenderit nga AK, ky i fundit disponon kontratat e qerasë për makinerin, e cila përmbanë të gjithë elementët e kërkuar nga vetë autoriteti kontraktor në dokumentat e tenderit. Megjithese nga AK ne menyre te qellimshme nuk eshte permendur dhe nuk eshte bere i ditur emri i OE qe e disponon me qera kete makineri pjesemarres ne kete procedur. Referuar dhe vendimeve te mepareshrne te KPP-se Vendim nr.157/2018 fakti qe dy OE pjesemarrese disponojne me qera te njetin mjete nuk mund dhe nuk duhet te perbeje shkake skualifikimi pasi mjeti do te perdoret nga OE i cili do te shpallet fitues. Pra pavaresisht se CILI OE e disponon kete makineri, në këtë procedurë prokurimi vetëm një subjekt do të shpallet fitues dhe vetëm ai subjekt do të perdor mjetin e marre me qera. Nqs ne nuk do të shpallemi fitues nuk do të perdorim mjetin, po e njëjta gjë vlene edhe per operatorin tjetër. Krirteri i vendosur nga AK eshte plotesuar nga shoqeria jone dhe pretendimi AK eshte i pabaze, i qellimshem dhe nuk mund te pranohet nga ana jone.

Ne lidhje me pretendimin se "Ne permbushje te pikes 2.3.13 "Per kapacitetin teknik" te dst Sperkates boje Makineri vijzimi, e deklaruar se disponohet nga te dy antaret e B.O.E, nga verifikimi i kryer rezulton se percakton Sperkates boje, por duke u nisur nga vlera nuk eshte per makineri vijezimi ne rruge, trotuare etj., sikurse eshte qellimi i vendosjes ne dokumentat e tenderit.

Sa me siper sqarojme se : Ne lidhje me pretendimin se Vlera e pajisjes Sperkates boje nuk i korespondon nje mjeti te tille, sqarojme se kemi paraqitur dokumentacion e nevojshem Fat.91 date 21.03.2019 qe verteton pronesin e kesaj paisje, e cila permbush kerkesen sipas DST, argumenti AK se cmimi i blerjes, vlera nuk eshte per makineri vijezimi ne rruge dhe trotuar eshte nje argument i qellimshem, i turpeshem dhe komprometues, per te cilen, me te gjitha menytrat dhe me argumente qesharake AK kerkon te sajoj mangesi dokumentacioni qe nuk ekzistojne. Per me teper nuk eshte aspak kopetence e AK te gjykoni mbi vlerat /cmimet e blerjes se nje makinerie apo pajisje per sa kohe qe keto jane Fatura te leshuara nga Subjekte te cilat i deklarojne dhe mbajne pergjegjesi ndaj

organit kopetent per leshimin e tyre. Krirteri i vendosur nga AK eshte plotesuar nga shoqeria jone dhe pretendimi AK eshte i pabaze , i qellimshem dhe nuk mund te pranohet nga ana jone.

Ne lidhje me pretendimin se “Bazuar ne ndarjen e punimeve midis shoqerive antare te B.O.E , rezulton se shoqeria “ED KONSTRUKSION” ka marr persiper te kryej zerat e preventivit “punime murature” “punime shtresash” “punime suvatimi e bojatisje te jashtme ”. Nga verifikimi i ketyre zerave dhe dokumentacionit te paraqitur, rezulton se kerkesat profesionale dhe ato teknike nuk permbushen nga shoqeria “ED KONSTRUKSION” ne perputhje me perqindjen e pjesemarrjes ne pune, te percaktuara ne akt marreveshje. Konkretisht ne preventivin e ketij prokurimi jane marre persiper te kryehen punime ndertimore si psh, ”veshje fasade me polisterol kompakt jeshil t=5cm+rrjet+suva” punime qe kerkojne drejtues teknik me profesion inxhinier ne profilet e ndertimit ose arkitekt, per pasoje edhe inxhinier qe do te kryej zbatimin e punimeve perkatese duhet te jete i certifikuar per auditimin e energiise, nga institucionet e arsimit te larte, por qe ky inxhinier i certifikuar nuk disponohet nga shoqeria ED KONSTRUKSION qe ka marre persiper te kryej keto punime. Pervec kesaj per efekt te kryerjes se punimeve ndertimore eshte gjykuar i nevojshem qe punonjesit qe do te realizojne punimet e ndertimit te asistohen edhe nga nje teknik ndertimi, por qe nga dokumentacioni i praqitur ne SPE nuk disponohet nga shoqeria “ED KONSTRUKSION”

Sa me siper ju sqarojme se; Se pari pretendimi i AK eshte nje pretendim absurd dhe aspak profesional, kjo tregon se ne kete institucion vleresimi i procedurave dhe dokumentacionit nuk eshte bere nga personat specialist pergjegjes dhe se vleresimi nuk eshte bere nga AK. Ndarja e zerave te punes midis shoqerive pjese e bashkimit eshte bere ne menyre korrekte dhe te sakte. Fakti qe ED KONSTRUKSION nuk disponon sipas AK Audituesin e Energjis dhe Teknik Ndertimi nuk perben mosplotesim te kerkesave tuaja pasi Drejtuesit Teknik te dy shoqerive jane Drejtues te te gjitha objektit, dhe se drejtimi teknik ne objekt behet nga drejtuesit teknik te paraqitur ne kete procedur nga ana jone si bashkim operatoresh. Zeri i punes ”veshje fasade me polisterol kompakt jeshil t=5cm+rrjet+suva” do te kryehet nga specialistet e shoqerise ED KONSTRUKSION dhe drejtimi teknik kryehet nga Drejtuesit Teknik te shoqerise Colombo te cilet plotesojne kerkesat e Dst. Per sa kohe ne jemi paraqitur si bashkim operatoresh do te thote qe kerkesat tuaja plotesohen nga bashkimi dhe jo nga secili operator me vete, pasi ne te kundert nuk do te ishte i nevojshem bashkepunimi. Ne vleresojme se bashkimi i operatorëve ekonomikë Colombo dhe ED KONSTRUKSION shpk disponojnë të gjitha kapacitetet, kualifikimiet e nevojshme teknike, profesionale etj të cilat përmbushin kërkesat në raport me natyrën e punimeve dhe elementët konkretë të realizimit të zërave të preventivit që autoriteti kontraktor synon të arrije në këtë procedurë prokurimi. Krirteri i vendosur nga AK eshte plotesuar nga shoqeria jone dhe pretendimi i KVO-se eshte i pabaze , i qellimshem dhe nuk mund te pranohet nga ana jone. Me cdo kushte AK kerkon te sajoje mangesi me qellim skualifikimin e shoqerise sone.

Ne lidhje me pretendimin se “Ne permbushje te pikes 2.3.13 “Per kapacitetin teknik” te dst, jane kerkuar 2 cope kamioncine me kapacitet mbajtes 1.5-2 ton. Nga shoqeria “ED KONSTRUKSION” jane paraqitur dy mjete me targa AA233MN dhe AA305TM qe jane konsideruar ne rregull me dokumentacionin, kurse nga shoqeria “COLOMBO” jane paraqitur mjete VL5914C, VL4533A, VL9884A, VL6465B, AA747ID ,AA416KL qe kane dokumentacionin te pashoqeruar me leje transporti, ose jane me kapacitet nen 1.5 ton. Si pasoje B.O.E nuk ka mundur te paraqese 3 cope mjete me dokumentacion te plote ligjor, sikurse eshte percaktuar ne dst.

Sa me siper ju sqarojme se; Shoqeria Colombo Shpk ka aplikuar per tu pajisur me Leje Transporti per mjetet e paraqitura ne kete procedur por sic e shprehem dhe me siper ne menyre te qellimshme per te penguar pjesemarrjen e shoqerise sone ne kete procedur, keto leje nuk jane firmosur nga ky institucion njekohesisht si Autoritet Kontraktor per kete procedur. Mjetet e paraqitura ne kete

procedur nga shoqeria jone kane kapacitetin e kerkuar ne DST. Kamioncina me targa VL9884A eshte me kapacitetet 1.5 ton, kamioncina AA416KL konsiderohet me kapacitet 1.5 ton, kamioncina me targa AA747ID konsiderohet me kapacitetin 1.5 Ton qe i pergjigjen kerkesave te DST, pasi sipas ligjit, Udhezim Nr.15, date 24.07.2007 per tonazhin e Mjeteve te Transportit nuk pajisen me Leje Transporti. Kamioncina VL9884 i pergjigjet kapacitetit te kerkuar dhe eshte paraqitur me te gjitha dokumentacionin e nevojshem sipas ligjit, nga AK kapaciteti i kesaj kamioncine eshte konsideruar me kapacitet me te vogel se 1.5 ton me qellim per tu marr si mangesi. Bashkimi i operatoreve Colombo & ED KONSTRUKSION ka permbushur kerkesen e DST per paraqitjen e tre kamioncinave. Perfundimisht argumentet e AK per gjoja mangesi te sajuara prej tij me qellim skualifikimin e shoqerise sone jane argumenta dhe pretendime te pambeshtetura as ne nje lloje dokumentacioni, as LPP dhe as ne dokumentat e paraqitur nga ana jone, por jane pretendime te sajuara dhe korruptive. Si mund te justifikohet nga ana AK diferenca e vleres se ofertave ne shumen prej 19 000 000 lekete te reja midis ofertes se shoqerise sone dhe ofertes se shoqerise SENKA shpk te cilen AK kerkon ta shpalle fitues, si do ta mund te marr persiper AK kete abuzim qe bene dhe demin qe po i shkaktoni shtetit. Ju bejme me dije se ky eshte nje deme ekonomik qe i shkaktohet shtetit nga ne menyre korruptive cka i ngarkone ata me pergjegjesi ligjore. Gjithe sa me siper veprimet e Autoritetit Kontraktor mbi skualifikimin e shoqerise sone, me mangesi te sajuara ne kushtet paraqitjes se ofertes me te mire ekonomike ne krahasim me OE te kualifikuar nga ana e tyre eshte ne shkelje te hapur te LPP respektivisht:...

...Nder te tjera Operatori Ekonomik SENKA i kualifikuar nga AK nuk i ploteson kriteret e kualifikimit te vendosura ne DST per kete arsye kerkojme skualifikimin e saj, nga informacionet konfidenciale qe kemi ka mungesa ne dokumentacion, nuk ploteson kerkesat per kapacitetin teknik dhe profesional te kerkuar sipas DST.

Referuar DST: 1. Operatori Ekonomik duhet te disponoje nje staf drejtues teknik te inxhinierëve te perbere prej:

ing.ndertimi 1 (një) (Proflli STRUKTURIST)

arkitekt 1 (një)

ing.gjeodet/topograf/markshajder 1 (një)

ing.mjedisi 1 (një)

ing.elektrik 1 (një)

ing mekanik 1 (një)

te shoqeruar me kontraten e punes, diplome, si dhe te figurojne ne listepagesa ne periudhen e kerkuar.

Nuk ploteson kerkesen e DST pasi nuk disponion Drejtues Teknikë të përfshirë në licencën e shoqërisë 1 Arkitekt.

Nuk disponon Drejtues Teknikë inxhlmer me profil strukturist.

Referuar pikes 5 te DST "Operatori ekonomik ofertues duhet të disponoje në stafin e tij dhe te figurojne ne listepagesa: Inxhinier Auditues energjie i pajisur me "Çertifikate per Auditimin e Energjise të dhënë nga institucionet te arsimit të lartë. Per te vertetuar plotesimin e ketij kriteri duhet te paraqese dokumentacionin sipas pikes 3 te kapacitetit teknik te shoqeruar me certifikaten per auditimin e energjise. Nuk ploteson kerkesen e DST pasi nuk disponon Inxhinier Auditues energjie i pajisur me "certifikate per auditimin e energjise/Eficenca e energjise ne ndertesa".

Referuar pikses 10 te DST: Operatori ekonomik ofertues duhet te kete te punesuar minimalisht 3 manovrator te mjeteve te renda dhe 3 shofer te mjeteve te renda. Për kete punonjës duhet të paraqitet kontrata e punës e vlefshme, dëshmia e drejtimit (të vlefshme), lëshuar nga institucioni

përkatëse si dhe të figurojnë në listpagesat e shoqërisë. Manovratorët A. H. dhe Sh. M. nuk janë të pajisur me leje manovrimi nga DPSHTRR.

Referuar pikes 13 te DST: Operatori ekonomik duhet te paraqese dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo mund ti vihen në dispozicion operatorit ekonomik, që nevojiten për ekzekutimin e kontratës:

Nuk diponon Autobot uji pasi ka paraqitur kontrate qeraje te pavlefshme per autobotin me targa AA120NA, te revokuar nga ana e qeradhenesit.

Nuk disponon Makineri per shperndarjen e kokrizave te gomes, pasi Fatura e paraqitur nga Senka shpk eshte fatur e sajuar pasi eshte mjete qe ne shqiperi e disponon vetem nje firm.

Nuk disponon elektroorgano dhe gazogjen, jane paraqitur fatura fiktive.

Mungon fatura tatimore e shitjes ose dokumenti i zhdoganimit për mjetin frezë Ęirtgen SF100K bashkangjitur kontratës së qirasë

Nuk disponon Vinçi kullë, faturat jane fiktive.

Nuk disponon vinc eskavator ,fatura eshte fiktive, faturat nuk i pergjigjen mjetit te kerkuar.

Nuk ploteson kriterin per paraqitjen e 3 kamioncinave, kamioncinat e paraqitura nga kjo shoqeri kane mangesi ne dokumentacion, per kamioncinen me targa AA435AV eshte paraqitur leje e qarkullimin fotokopje dhe jo e noterizuar.

Shume nga mjete si eskavatori me goma me targa AEMT11 dhe rruli BĚ-2163-3 i disponon me qera dhe shoqeria Inerti Shpk.[...]"

II.8.Në datën 17.07.2019, me anë të shkresës nr.5815/1prot., datë 10.07.2019, ka mbërritur pranë Komisionit të Prokurimit Publik, informacioni i autoritetit kontraktor në lidhje me procedurën e prokurimit të sipërcituar.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dhe kërkesës të BOE ankimues,

Arsyeton:

III.1.Lidhur me pretendimin e BOE ankimues “Colombo” sh.p.k. & “Ed Konstruksion” sh.p.k., mbi skualifikimin e ofertës së tij, në procedurën e prokurimit objekt shqyrtimi me arsyen: [...]Në plotësimin e vetëdeklaratës me shkrim të subjektit, të paraqitur nga anëtarët e bashkimit vecmas, në ditën e hapjes së ofertës, sipas shtojcës 8, rezulton se nuk përcakton të gjithë ortakët, administratorët. Në shtojcën 8 të dst përcaktohet se operatori ekonomik deklaron “personi/at në cilësinë e anëtarit të organit administrativ, drejtuesit ose mbikëqyrësit, aksionerit ose ortakut, ose ka kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik”. Konkretisht nga verifikimi i ekstraktit historik të shoqërisë “COLOMBO” rezulton se ka edhe nje drejtues teknik Erjona Qatipi të padeklaruar në shtojcën 8, kurse nga verifikimi i ekstraktit historik të shoqërisë “ED KONSTRUKSION” rezulton se ka të padeklaruar në shtojcën 8, ortakun E. I., J. I., R. I., ekspertit kontabël V. L. [...]", Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.1.1.Në shtojcën 8, “Deklaratë mbi përmbushjen e kriterëve të përgjithshme”, në dokumentat standarte të tenderit të procedurës së prokurimit objekt ankimi, autoriteti kontraktor është përcaktuar si më poshtë vijon:

“Deklaratë e operatorit ekonomik pjesëmarrës në procedurën e prokurimit që do të zhvillohet në datë _____ nga Autoriteti Kontraktor _____ me objekt _____ me fond limit _____.

Unë i nënshkruari _____ me cilesinë _____ të operatorit ekonomik _____ deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë se:

•Operatori ekonomik _____ është i regjistruar në Qendrën Kombëtare të Biznesit dhe ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit. Në rastin kur ofertuesi është një organizatë jofitimprurëse, duhet të deklarojë se është i regjistruar si person juridik, sipas Ligjit Nr.8788, datë 07.05.2001 “Për Organizatat jo Fitimprurëse”.

•Operatori ekonomik _____ nuk është dënuar për asnjë nga veprat penale, të parashikuara Nenin 45/1 të LPP.

•Personi/at në cilësinë e anëtarit të organit administrativ, drejtuesit ose mbikëqyrësit, aksionerit ose ortakut, ose ka kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik, si më poshtë:

_____ etj.

nuk janë ose kanë qenë të dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për asnjë nga veprat penale, të përcaktuara në nenin 45/1 të LPP .

•Operatori ekonomik _____ nuk është dënuar me vendim të gjykatës së formës së prerë, për vepra që lidhen me veprimtarinë profesionale.

•Operatori ekonomik _____ nuk është në proces falimentimi (statusi aktiv).

•Operatori ekonomik _____ ka paguar të gjitha detyrimet për pagimin e tatimeve e të kontributeve të sigurimeve shoqërore, sipas legjislacionit në fuqi.

Në çdo rast, autoriteti kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatorit ekonomik si më sipër.

Data e dorëzimit të deklaratës _____

Nënshkrimi i ofertuesit _____

Vula _____”

III.1.2. Operatorët ekonomikë “Colombo” sh.p.k. dhe “Ed Konstruksion” sh.p.k., kanë krijuar bashkimin e përkohshëm të shoqërive me anë të kontratës së bashkëpunimit të lidhur para një noteri Nr.1118Rep., Nr.824Kol. Referuar kontratës së bashkëpunimit të mësipërme parashikohet se:

“[...]Shoqëria “Colombo” sh.p.k., do te mbuloje 67% te angazhimit te kontrates me Autoritetin Kontraktor. Shoqëria “Ed Konstruksion” sh.p.k., do te mbuloje 33% te angazhimit te kontrates kryesore me Autoritetin Kontraktor.

Ndarja e detajuar e puneve sipas zerave do te jete sipas preventivit te ndarjes se punimeve bashkengjitur kontrates se bashkepunimit[...]”

III.1.3.Në nenin 46, pika 1, të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar parashikohet shprehimisht se: *“Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohen dhe jodiskriminuese.”*

Ndërsa në nenin 53/3 të LPP-së përcakohet se: *“Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një oferte të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit.”*

III.1.4.Në nenin 45, të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” parashikohet shprehimisht se: *“1. Autoriteti kontraktor skualifikon nga procedura e përzgjedhjes së fituesve të kontratave publike çdo operator ekonomik, nëse është ose ka qenë i dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë, për ndonjë nga veprat penale të mëposhtme:*

- a) pjesëmarrje në grup të strukturuar kriminal, organizatë kriminale, bandë e armatosur, organizatë terroriste;*
- b) korrupsion;*
- c) mashtrim;*
- ç) pastrim parash ose financim i terrorizmit;*
- d) vepra me qëllime terroriste ose vepra penale të lidhura me veprimtari terroriste;*
- dh) organizim, drejtim ose financim i veprimtarisë së prodhimit dhe shitjes së narkotikëve, si dhe i veprimtarisë së trafikimit të narkotikëve;*
- e) falsifikim;*
- ë) shfrytëzim i punës së të miturve dhe forma të tjera të trafikimit të qenieve njerëzore.*

Detyrimi për të skualifikuar një operator ekonomik zbatohet edhe kur personi i dënuar me një vendim gjyqësor të formës së prerë është anëtar i një organi administrativ, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, operator ekonomik, ose ka kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij.

2. Çdo operator ekonomik skualifikohet nga një procedurë , në rastet kur:

- a) ka falimentuar dhe kapitalet e tij janë në proces ekzekutimi nga përmbaruesit ;*
- b) është subjekt i procedurave për deklarimin e falimentimit dhe ka një urdhër likuidimi të detyruar ose administrimi nga gjykata, ose ka një marrëveshje me kreditorët, ose ndonjë procedurë tjetër të ngjashme;*
- c) është dënuar me vendim gjykate të formës së prerë për vepra që lidhen me veprimtarinë profesionale;*
- ç) ;*
- d) nuk i ka përmbushur detyrimet për derdhjen e kontributeve të sigurimeve shoqërore, në përputhje me legjislacionin shqiptar ose me dispozitat e zbatueshme në shtetin e origjinës;*
- dh) nuk i ka përmbushur detyrimet për pagimin e tatimeve, në përputhje me legjislacionin shqiptar ose me dispozitat e zbatueshme në shtetin e origjinës;*

e) është fajtor për dhënie të informacioneve të rreme, kur këto i janë kërkuar në përputhje me këtë kre , ose nuk ka pranuar t'i japë këto informacione ose dokumente apo një pjesë të tyre.

ë) me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik është përjashtuar nga pjesëmarrja në procedurat e prokurimit, sipas pikës 3, të nenit 13, të këtij ligji.

3. Me qëllim plotësimit e kushteve të parashikuara në pikat 1 dhe 2 të këtij neni, operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin si më poshtë:

a) Vërtetim nga dosja gjyqësore, ose një dokument të njëvlefishëm, të lëshuar nga një autoritet kompetent gjyqësor apo administrativ që vërteton se nuk ekzistojnë kushtet e parashikuara në pikat 1 dhe 2, shkronja “a”, “b” dhe “c” .

b) një vërtetim të lëshuar nga organi kompetent, që vërteton se nuk ekzistojnë çështjet e përmendura në pikën 2 shkronjat “d” e “dh””

III.1.5.Neni 74, pika 1, 2 dhe 3 të VKM 914/2014 parashikohet se : “1. Oferta mund të paraqitet nga një bashkim operatorësh ekonomikë, ku njëri prej të cilëve i përfaqëson të tjerët gjatë procedurës dhe në rast përzgjedhjeje edhe gjatë zbatimit të kontratës. Në ofertë duhet të përcaktohet pjesa e shërbimit, punës ose furnizimit, që do të kryejë secili nga anëtarët e këtij bashkimi..... 2. Para dorëzimit të ofertës, bashkimi duhet të krijohet zyrtarisht, me një marrëveshje të noterizuar, ku të përcaktohen përfaqësuesi i grupit, përqindja e pjesëmarrjes së punës/shërbimit/furnizimit dhe elementet konkrete, që do të kryejë secili nga anëtarët e këtij bashkimi. Pas krijimit të bashkimit të operatorëve ekonomikë, anëtarët e bashkimit caktojnë me prokurë përfaqësuesin e tyre për dorëzimin e ofertës. Kjo marrëveshje e shkruar dhe prokura duhet të dërgohen së bashku me kualifikimet dhe ofertën ekonomike, e cila duhet të nënshkruhet nga përfaqësuesi. Përfaqësuesi duhet të bëjë edhe sigurimin e ofertës, nëse kërkohet, duke specifikuar pjesëmarrjen në bashkimin e operatorëve ekonomikë. Në rast se bashkimi I operatorëve ekonomikë shpallet fitues, kontrata duhet të nënshkruhet nga secili prej anëtarëve të këtij bashkimi. “3. Secili prej anëtarëve të këtij bashkimi duhet të përmbushë kërkesat ligjore, të parashikuara në nenin 45 të LPP dhe ato të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Kërkesat ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me përqindjen e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në aktmarrëveshje”

III.1.6. Nga verifikimet e kryera në sistemin e prokurimeve elektronike, rezulton se BOE ankimues “Colombo” sh.p.k. & “Ed Konstruksion” sh.p.k., në përmbushje të kriterit sa më sipër, kanë dorëzuar deklaratat respektive sipas shotjçës mbi përmbushjen e kriterëve të përgjithshme, të nënshkruara nga administratorët e shoqërive përkatëse. Nga shqyrtimi i deklaratave të dorëzuara nga bashkimi i operatorëve ekonomike ankimues, rezulton se anëtari i bashkimit të operatorëve ekonomik “Ed Konstruksion” sh.p.k., ka deklaruar: “Personi/at në cilësinë e anëtarit të organit administrativ, drejtuesit ose mbikëqyrësit, aksionerit ose ortakut, ose ka kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik, si më poshtë: Alfred Ibrahim i nuk janë ose kanë qenë të dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për asnjë nga veprat penale, të përcaktuara në nenin 45/1 të LPP”

III.1.7. Bazuar në arsyen e skualifikimit, si dhe nga shqyrtimi i ekstraktit tregtar të shoqërisë “Ed Konstruksion” sh.p.k., Komisioni konstatoi se Z. Alfred Ibrahim i nuk është ortak i vetëm i kësaj shoqërie, por pjesëtar të kapitalit të saj janë edhe ortakët R.I., J.I. dhe E.I. Referuar legjislacionit për prokurimin publik, vendosja e kriterëve të kualifikimit kanë si synim kryesor që t'i shërbejnë

autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Komisioni i Prokurimit Publik sqaron se është detyrim ligjor i subjektit ofertues të provojë me dokumentacion të plotë dhe në përputhje me kërkesat e autoritetit kontraktor plotësimin e kriterëve të kërkuara në dokumentat e tenderit, pasi ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumenta duhet të refuzohen si të papranueshme. Kriteret kualifikuese të përcaktuara nga autoriteti kontraktor, janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga të gjithë ofertuesit ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi. Autoriteti kontraktor, do të konsiderojë një ofertë të vlefshme, nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit në respekt të pikës 3 të nenit 66 të VKM nr.914 datë 29.12.2014 i ndryshuar. Në rastin konkret, Komisioni gjykon se, anëtari i bashkimit të operatorëve ekonomikë “Ed Konstruksion” sh.p.k., nuk ka paraqitur deklaratën sipas shotjçës 8 të dokumentave të tenderit në përputhje me parashikimet ligjore të nenit 45 të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, pasi ky i fundit ka patur detyrimin e deklaramentit për të gjithë ortakët e shoqërisë. Në këto kushte, Komisioni gjykon se, skualifikimi i BOE ankimues nga ana e autoritetit kontraktor është i drejtë.

Sa më sipër, pretendimi i BOE ankimues nuk qëndron.

III.2.Lidhur me pretendimin e BOE ankimues “Colombo” sh.p.k. & “Ed Konstruksion” sh.p.k., mbi skualifikimin e ofertës së tij, në procedurën e prokurimit objekt shqyrtimi me arsyen: *[...]Bazuar në ndarjen e punimeve midis shoqërive anëtare të B.O.E, rezulton se shoqëria “ED KONSTRUKSION” ka marrë përsipër të kryejë zërat e preventivit “punime murature”, “punime shtresash”, “punime suvatimi e bojatisje të jashtme”. Nga verifikimi i këtyre zërave dhe dokumentacionit të paraqitur, rezulton se kërkesat profesionale dhe ato teknike nuk përmbushen nga shoqëria “ED KONSTRUKSION”, në përputhje me përqindjen e pjesëmarrjes në punë, të përcaktuara në akt marrëveshje. Konkretisht në preventivin e këtij prokurimi janë marrë përsipër të kryhen punime ndërtimore si psh “veshje fasade me polisterol kompakt jeshil T=5cm + rrjete + suva”, punime që kërkojnë drejtues teknik me profesion inxhinier në profilet e ndërtimit ose arkitekt, për pasojë edhe inxhinieri që do të kryejë zbatimin e punimeve përkatëse duhet të jetë i certifikuar për auditimin e energjisë, nga institucionet e arsimit të lartë, por që ky inxhinier i certifikuar nuk disponohet nga shoqëria ED KONSTRUKSION” që ka marrë përsipër të kryejë këto punime. [...]*”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.2.1.Në shtojcën 12, pika 2.3.5.“Për kapacitetin teknik”, në dokumentat standarte të tenderit të procedurës së prokurimit objekt ankimi, autoriteti kontraktor ka kërkuar, si më poshtë vijon:

“Operatori ekonomik ofertues duhet të disponoje në stafin e tij dhe te figuroje ne listepagesa: Inxhinier – Auditues energjie i pajisur me ”Çertifikate per Auditimin e Energjise”, të dhënë nga institucionet te arsimit të lartë. Per te vertetuar plotësimin e këtij kriteri duhet te paraqese

dokumentacionin sipas pikës 3 të kapacitetit teknik të shoqëruar me certifikatën për auditimin e energjisë”

III.2.2. Në nenin 46, pika 1, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” parashikohet shprehimisht se: “Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohen dhe jodiskriminuese.”

Ndërsa në nenin 53/3 të LPP-së përcaktohet se: “Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit.”

III.2.3. Neni 74, pika 1, 2 dhe 3 të VKM 914/2014 parashikohet se : “1. Oferta mund të paraqitet nga një bashkim operatorësh ekonomikë, ku njëri prej të cilëve i përfaqëson të tjerët gjatë procedurës dhe në rast përzgjedhjeje edhe gjatë zbatimit të kontratës. Në ofertë duhet të përcaktohet pjesa e shërbimit, punës ose furnizimit, që do të kryejë secili nga anëtarët e këtij bashkimi..... 2. Para dorëzimit të ofertës, bashkimi duhet të krijohet zyrtarisht, me një marrëveshje të noterizuar, ku të përcaktohen përfaqësuesi i grupit, përqindja e pjesëmarrjes së punës/shërbimit/furnizimit dhe elementet konkrete, që do të kryejë secili nga anëtarët e këtij bashkimi. Pas krijimit të bashkimit të operatorëve ekonomikë, anëtarët e bashkimit caktojnë me prokurë përfaqësuesin e tyre për dorëzimin e ofertës. Kjo marrëveshje e shkruar dhe prokurë duhet të dërgohen së bashku me kualifikimet dhe ofertën ekonomike, e cila duhet të nënshkruhet nga përfaqësuesi. Përfaqësuesi duhet të bëjë edhe sigurimin e ofertës, nëse kërkohet, duke specifikuar pjesëmarrjen në bashkimin e operatorëve ekonomikë. Në rast se bashkimi I operatorëve ekonomikë shpallet fitues, kontrata duhet të nënshkruhet nga secili prej anëtarëve të këtij bashkimi. “3. Secili prej anëtarëve të këtij bashkimi duhet të përmbushë kërkesat ligjore, të parashikuara në nenin 45 të LPP dhe ato të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Kërkesat ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me përqindjen e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në aktmarrëveshje”.

III.2.4. Neni 26, pika 8, e Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 914, datë 29.12.2014 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, parashikon shprehimisht se : Për të provuar kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti kontraktor kërkon:

a) licenca profesionale të shoqërisë për realizimin e punimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore; dhe/ose

b) dëshmi për fuqinë punëtore të operatorit ekonomik të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit; dhe/ose

c) dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

III.2.5. Komisioni i Prokurimit Publik, referuar dokumentacionit të paraqitur nga BOE ankimues në përmbushje të kriterit kualifikues, lidhur me disponueshmërinë e Inxhinierit Auditues energjie i pajisur me “Çertifikatë për Auditimin e Energjisë”, konstaton se anëtari i bashkimit të operatorëve ekonomikë “Ed Konstruksion” sh.p.k., referuar marrëveshjes së bashkëpunimit ka marrë përsipër të përmbushë 33% të kontratës objekt prokurimi, përkatësisht, të gjitha zërat e pikës IX të preventivit

*“Punime suvatimi e bojatisje te jashtme”, për këtë arsye, operatori ekonomik “Ed Konstruksion” sh.p.k., referuar zërave të preventivit të marrë përsipër për të kryer, duhet të dëshmonte me anë të dokumentacionit se disponon një Inxhinier Auditues energjie i pajisur me ”Çertifikatë për Auditimin e Energjisë”. Nga verifikimet e kryera nga Komisioni në SPE, rezulton se operatori ekonomik “Ed Konstruksion” sh.p.k. nuk ka paraqitur dokumentacion për të provuar disponueshmërinë Inxhinierit Auditues energjie i pajisur me ”Çertifikatë për Auditimin e Energjisë”. Kriteret për kualifikim vendosen që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion realizimit me sukses të kontratës. Në rastin konkret, për autoritetin kontraktor është e rëndësishme të provohet që operatori ekonomik zotëron kapacitetet teknike (personelin), në përputhje me volumin e përcaktuar në dokumentat e tenderit. Në këto kushte, KPP gjykon se anëtari i bashkimit të përkohshëm të shoqërive “Ed Konstruksion” sh.p.k. është në kushtet e mospërbushjes së kriterëve të vecanta të kualifikimit pasi ky i fundit nuk arrin të përmbush kriterin e vendosur nga autoriteti kontraktor në shtojcën nr. 12, pika 2.3.5, “Për kapaciteti teknik” në dokumentat standarte të tenderit në procedurën e prokurimit objekt ankimi, sipas kontratës së bashkëpunimit, në përputhje me VKM nr.914 datë 29.12.2014 ”Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” e cila në nenin 74 pika 3 e cila parashikon shprehimisht se: *”Kërkesat ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me përqindjen e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në aktmarrëveshje”.**

III.2.6. Në rast se BOE ankimues “Colombo” sh.p.k. & “Ed Konstruksion” sh.p.k. do të kishte pretendime në lidhje me kërkesën e mësipërme të autoritetit kontraktor, ka patur në dispozicion momentin procedural të paraqitjes së ankesës mbi hartimin e dokumenteve dhe kriterëve të veçanta të kualifikimit të procedurës së prokurimit objekt ankimi, parashikuar nga neni 63 pika 1/1 e LPP. Në nenin 63 pika 1/1 të ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 *“Për Prokurimin Publik”*, i ndryshuar parashikohet se *“Në rastin e ankesave për dokumentet e tenderit, operatorët ekonomikë mund të ankohen pranë autoritetit kontraktor brenda 7 ditëve nga data e publikimit të njoftimit të kontratës në faqen në internet të Agjencisë së Prokurimit Publik. Me marrjen e ankesës me shkrim, autoriteti kontraktor pezullon vazhdimin e procedurës së prokurimit, derisa ankesa të jetë shqyrtuar plotësisht, përfshirë dhe nxjerrjen e një vendimi brenda 3 ditëve nga data e depozitimit të ankesës. Ndaj vendimit përfundimtar të autoritetit kontraktor mund të bëhet ankim në Komisionin e Prokurimit Publik, në përputhje me pikën 6 e në vijim të këtij neni”.* Gjithashtu, kuadri ligjor parashikon një sërë elementësh si garanci për operatorët ekonomikë të cilët kanë paqartësi në lidhje me interpretimin e kërkesave të autoritetit kontraktor dhe/ose mënyrës së plotësimit të kriterëve kualifikuese. Në rast se operatori ekonomik ankimues do të kishte paqartësi në lidhje mbi plotësimin e kërkesës së mësipërme, ka në dispozicion momentin procedural të paraqitjes së kërkesës për sqarime pranë autoritetit kontraktor deri në pesë ditë para dorëzimit të ofertave parashikuar nga neni 42 i LPP-së. Në nenin 42, pika 1 të ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 *“Për Prokurimin Publik”*, i ndryshuar, parashikohet se *“[...] Ofertuesi i mundshëm mund të kërkojë sqarime për dokumentet e tenderit nga autoriteti kontraktor, i cili duhet t’i përgjigjet çdo kërkesë për sqarim të dokumenteve të tenderit, të bërë nga çdo operator ekonomik, me kusht që kërkesa të jetë marrë jo më vonë se 5 ditë para afatit përfundimtar të dorëzimit të ofertave. Autoriteti kontraktor duhet të përgjigjet brenda 3 ditëve nga depozitimi i kërkesës, në mënyrë që të bëjë të*

mundur dorëzimin e ofertës në kohë nga operatori ekonomik dhe, pa identifikuar burimin e kërkesës, duhet t'ia komunikojë sqarimin përkatës të gjithë operatorëve ekonomikë, që kanë tërhequr dokumentet e tenderit [...]”. Sa më sipër, pretendimi i BOE ankimues nuk qëndron.

III.3.Lidhur me pretendimet e tjera të BOE ankimues “Colombo” sh.p.k. & “Ed Konstruksion” sh.p.k. për skualifikimin e ofertës së tij, në procedurën e prokurimit objekt ankimi, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se për sa kohë që pretendimet e mësipërme nuk qëndrojnë, pasi BOE nuk përmbush kriteret e kualifikimit dhe gjendja e tij faktike juridike pas arsyetimit të K.P.P. do të mbetet e skualifikuar, shqyrtimi në themel i pretendimeve të tjera të palës ankimuese nuk ndryshojnë gjendjen juridike të këtij bashkimi operatorësh ekonomik e për rrjedhojë nuk do të merren në shqyrtim në respekt të parimit të ekonomisë në shqyrtimin administrativ

III.4.Lidhur me pretendimet e BOE ankimues “Colombo” sh.p.k. & “Ed Konstruksion” sh.p.k. mbi kualifikimin e ofertës të operatorit ekonomik “Senka” sh.p.k., Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se:

III.4.1.Neni 63, pika 1, i Ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” (i ndryshuar), parashikon se: *“Çdo person, që ka ose ka pasur interes në një procedurë prokurimi dhe kur është dëmtuar ose rrezikohet të dëmtohet nga një vendim i autoritetit kontraktor, i marrë në kundërshtim me këtë ligj, mund ta kundërshtojë vendimin.”*

III.4.2.Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se një person fizik apo juridik, kur dorëzon një ankim, duhet të argumentojë se të drejtat e tij të mbrojtura nga legjislacioni janë dëmtuar si rezultat i një vendimi, mase apo të ndonjë veprimi tjetër zyrtar nga ana e një autoriteti kontraktor. Nëse ai dështon në sa më sipër, atëherë ankimi në KPP nuk mund të pranohet. Neni 63, pika 1 kërkon shprehimisht që operatori ekonomik ankimues, jo vetëm që duhet të ketë interes, por edhe të jetë dëmtuar realisht apo të rrezikohet të dëmtohet nga vendimi që ka marrë autoriteti kontraktor. Në ato raste kur, operatori ekonomik ankimues edhe pas ankimit në KPP rezulton i skualifikuar nga procedura e prokurimit, atëherë ai qartësisht nuk mund ta fitojë kontratën. Edhe në hipotezën se, pretendimet e parashtruara në ankimin e tij në lidhje me operatorët e tjerë pjesmarrës në procedurën e prokurimit, do të pranohen nga KPP, ankimuesi sërish nuk do të ishte fitues i kontratës. Rrjedhimisht, në rast se operatori ekonomik që ka paraqitur ankimin vijon të mbetet i skualifikuar apo skualifikohet gjatë shqyrtimit në KPP, në kuptim të ligjit, interesi i tij i ligjshëm i drejtpërdrejtë nuk ka sesi të dëmtohet nga sukcesi apo dështimi i operatorëve të tjerë në atë procedurë prokurimi.

Për këtë arsye, këto pretendime nuk do të merren në shqyrtim.

Për sa më sipër, në mbështetje të nenit 19/1 dhe vijues, të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar, nenit 31 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri

Vendos:

1. Të mos pranojë ankesën e BOE “Colombo” sh.p.k. & “Ed Konstruksion” sh.p.k., për procedurën e prokurimit “*Procedurë e Hapur*”, me nr. *REF-19646-04-25-2019*, me objekt: “*Rikonstruksion i shkollës “24 Maji” dhe ambienteve sportive, Vlorë*”, me fond limit 82,981,479 lekë (pa TVSH), zhvilluar në datën 03.06.2019, nga autoriteti kontraktor, Bashkia Vlorë.
2. Autoriteti kontraktor lejohet të vijojë me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit të sipërcituar.
3. Kundër këtij vendimi, mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë, Tiranë.
4. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Nr. 1171 protokoli Datë 28.06.2019;

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nënkryetar
Enkeleda Bega

Anëtar
Vilma Zhupaj

Anëtar
Lindita Skeja

Anëtar
Merita Zeqaj

Kryetar
Evis Shurdha